



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datën 21.11.2014 Avokati i Popullit-Mekanizmi parandalues Nacional (MPN) realizoi **vizitë pasuese të natës** në SP Qendër e cila kishte për qëllim ta kontrollojë implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportin nga vizita e rregullt e realizuar më datën 24.02.2012.

MPN-ja realizoi **vizitë të paparalajmëruar pasuese** në Stacionin policor-Qendër në suaza të mandatit dhe ingerencave të përcaktuara në Protokollin Fakultativ të Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

Vizita në Stacionin Policor-Qendër u realizua në disa hapa. Ekipi i Mekanizmit parandalues nacional fillimishtë sqaroi qëllimin e vizitës pranë përgjegjësit të turnit të stacionit policor, ndërkaq mëpas realizoi inspektim në ambientet për ndalim, tualetët për persona të ndalur, si dhe inspektim në Librin për ngjarje të ditës, Evidencën për persona të privuar nga liria dhe persona të ndalur dhe Evidencën për persona të arrestuar. Duke marrë parasysh se vizita u realizua në orët e natës nuk u bë këqyrje në dosjet individuale për persona të ndalur. MPN-ja gjatë vizitës nuk hasi në person të ndalur me të cilin do të mundeshte të realizonte bisedë për kushtet, trajtimin dhe realizimin e të drejtave në procedurë policore.

Gjatë kohës së vizitës pasuese MPN-ja u njoftua nga ana e përgjegjësit të turnit se ushqimi i cili sigurohet për personat e ndalur kompensohet duke treguar llogari fiskale, përkatësisht në atë mënyrë sigurohen mjete për shujtë për personat të cilët ndalen në SP-Qendër. Ndaj rekomandimit që me kujdes t'i qasen rasteve që janë në gjendje të alkoolizuar dhe shenjave të dukshme të çrregullimeve të gjendjes shëndetësore te personi i ndalur, detyrimisht të thirret mjeku edhe pse vet personi i ndalur këtë nuk e ka kërkuar, MPN-ja konstatoi se në raste kur personat e privuar nga liria janë në gjendje tejet të alkoolizuar, dërgohen në Klinikën për toksikologji. Njëherazi, në drejtim të evidentimit të ndihmës mjeksore udhëhiqet edhe Procesverbali për të drejtën për mjek në të cilin evidentohet se a ka kërkuar personi mjek, si dhe cila është arsyeja për thirrje/arrestim/ndalim të personit të privuar nga liria i cili kërkon mjek.

Gjatë vizitës është konstatuar se të drejtat janë vendosur në vend të theksuar në zyrën e përgjegjësit të turnit, të cilat njëkohësisht edhe gojarisht u bëhen me dije personave të privuar nga liria nga ana e personit përgjegjës zyrtar. Gjithashtu, janë shtypur mini-fletushka për të drejtat në disa gjuhë të cilat u dedikohen personave të cilët nuk kuptojnë gjuhën maqedone. Gjatë inspektimit në tualetët për persona të ndalur është konstatuar se SP-Qendër ka eliminuar sendet e rrezikshme, që don të thotë se në të njëjtin nuk ka pasqyrë dhe dush. Në të ardhmen është e nevojshme që gjatë ndërtimit të tualetëve për persona të ndalur të merret parasysh mundësia për thyerjen e sendeve prej qeramike dhe të vendosen wc-guaca dhe lavamanë të cilët nuk do të jenë të thyeshëm.

Nga inspektimi në evidencën u konstatua se në Regjistrin për të arrestuar, si dhe në Regjistrin për persona të privuar nga liria dhe persona të ndalur në mënyrë të qartë ceket

kategoria e personave. Njëherazi në evidencën shënohen arsyet e arrestimit/privimit nga liria, ndërkaq mbahet llogari edhe për rrjedhën e logjikshme të ngjarjeve (udhëzimi është dhënë pas momentit të privimit nga liria).

Mekanizmi parandalues nacional në raportin për vizitën pasuese shprehu brengosje për privimin e fëmijëve nën 14 vjeç për të cilët ka shpallje për person të zhdukur, si dhe fëmijë të cilët lypin në rrugë. E njëjta u konstatua nga inspektimi në Librin për ngjarje të ditës si dhe nga Libri për persona të privuar. Konform ligjit për drejtësi për fëmijët, personat deri në moshën 14 vjeçare nuk mund të arrestohen, ndërkaq është e nevojshme të informohen organet kompetente për ndërmarrjen e masave për fëmijë të rrezikuar. Në këtë drejtim MPN-ja kërkoi nga Ministria për Punë të Brendshme të përpilojë procedurë operative për trajtimin e fëmijë të cilët lypin, si dhe për fëmijë të cilët udhëhiqen si persona të zhdukur, konform Protokollit multidisiplinar për veprime me fëmijë në rrugë në Republikën e Maqedonisë, si dhe respektim të plotë të të drejtave të fëmijëve konform Ligjit për të drejtat e fëmijëve.

Si rezultat i vizitës së realizuar Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional hartoi raport të veçantë në të cilin konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse të adresuara pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë Kryeshefit të Stacionit policor me qëllim të shmangies së mangësive të identifikuara.